



**POSTA DHE TELEKOMUNIKACIONI I KOSOVËS
SH.A.**

**Pasqyrat e Konsoliduara Financiare së bashku me
Raportin e Auditorit të Pavarur**

31 Dhjetor 2008

Përmbajtja

	Faqe
<i>Raporti i Auditorit të Pavarur</i>	<i>1</i>
<i>Bilanci i Konsoliduar i Gjendjes</i>	<i>3</i>
<i>Pasqyra e Konsoliduar e të Ardhurave</i>	<i>4</i>
<i>Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet</i>	<i>5</i>
<i>Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Parasë</i>	<i>6</i>
<i>Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Finaciare</i>	<i>7-35</i>

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton DOO
M.H.Jasmin 52 v-1/7
1000 Skopje
Macedonia

T +389 (2) 3214 700
F +389 (2) 3214 710
www.grant-thornton.com.mk

Për Menaxhmentin dhe Aksionarët e
Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara që shoqërojnë këtë raport të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Holding Sh.a. dhe njërive të saj (me tej referuar si “Grupi”), të cilat përbëhen nga Bilanci i konsoliduar më 31 Dhjetor 2008, dhe Pasqyra e konsoliduar të ardhurave, Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese, të përfshira në faqe 3 deri 35.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat e konsoliduara financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave të konsoliduara të kontabilitetit në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm relevant me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave të konsoliduara financiare të cilat janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura të kontabilitetit; dhe zbatimin e vlersimeve të kontabilitetit që janë të arsyshme për rrethanat

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim mbi këto pasqyra të konsoliduara financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Përveq siq është treguar tek paragrafi “Baza për mendimin e kualifikuar”, ne e kemi zhvilluar auditimin tonë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat si dhe të planifikojmë dhe zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme nëse janë pasqyrat e konsoliduara financiare të lira nga gabimet materiale. Një auditimi përfshin zbatimin e procedurave për marrjen e dëshmisë audituese për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat e konsoliduara financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlersimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave të konsoliduara financiare, pa marrë parasysh nëse janë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë zbatimit të këtyre vlersimeve të riskut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm relevant me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë nga entiteti të pasqyrave të konsoliduara financiare në mënyrë që të dizajnijë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së një mendimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim gjithashtu përfshin vlersimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura si dhe arsyeshmërinë e vlersimeve të kontabilitetit të kryera nga Menaxhmenti, gjithashtu edhe vlersimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave të konsoliduara të kontabilitetit.

Ne besojmë se dëshmia auditve të cilën e kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhura për të ofruar një bazë për mendimin tonë të auditimit.

Baza për mendimin e kualifikuar

Siq është shpalosur në shënimin 10 të pasqyrave financiare që shoqërojnë këtë raport, më 31 Dhjetor 2008, bilanci i llogarive të arkëtueshmeve tregtare është 17,827 mijë Euro, neto e provisionit për dëmtimin e borxheve të dyshimta është 35,551 mijë Euro. Ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe ato alternative të auditimit, të arrijmë siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të llogarive të arkëtueshmeve tregtare të Grupit në datën e bilancit të gjendjes.

Mendimi i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, për Veç sa u përket çështjeve të diskutuara në paragrafët paraprak, pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 Dhjetor 2008, si dhe performancën e tij financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhë të parasë për vitin e përfunduar në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Thëksim i çështjes

Pa e kualifikuar më tej mendimin tonë, ne tërheqim vëmendjen për çështjet në vazhdim: Siq është shpalosur në Shënimin 26 të pasqyrave të konsoliduara financiare në datën e bilancit të gjendjes ekzistojnë çështje të rëndësishme pronësore në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillim të administrimit të OKB-së në Kosovë, dhe mungesa e matjes dhe cilësimit sasior të besueshëm të ndikimi potencial financiar.

Siq është shpalosur në Shënimin 28 të pasqyrave të konsoliduara financiare burimet kryesore të pasigurisë së vlersimeve të menaxhmentit ndërlidhen me mundësinë e rikthimit të llogarive bankare dhe depozitave të vendosura në Bankën Kreditore të Prishtinës Sh.a. si dhe mungesa e matjes dhe cilësimit sasior të besueshëm të ndikimit potencial financiar nga pasiguria pronësore që ndërlidhet me interesin në tokën dhe ndërtesat e përdorura në aktivitetet biznesore të Grupit.

Veç kësaj siq është shpjeguar në Shënimin 28, Grupi lidh thirrjet fikse ndërkombëtare me administratat e huaja përmes linjave të menaxhuara nga Telekom Serbia. Pasi që nuk ka marrëveshje të ndërlidhjes ndërmjet PTK-së dhe Telokom Serbisë e cila do të rregullonte marrëdhëniet e përbashkëta sa i përket trafikut të telekomunikacionit atëherë efekti financiar i trafikut të ndërlidhjes nuk mund të matet dhe cilësohet për nga sasia me besueshmëri.


Grant Thornton

Shkup,
13 Mars 2009

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Bilanci i Konsoliduar i Gjendjes

Më 31 Dhjetor 2008

(në mijë Euro)

	Shënimi	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
ASETET			
Prona, impiantet dhe paisjet	6	114,448	109,034
Asetet e patrupëzuara	7	15,661	12,507
Garancitë e dajles për Monaco Telecom International		-	2,000
Investimet afatgjata financiare	12	-	5,254
Pasuritë e tatimit të shtyrë	8	2,988	6,915
Totali i aseteve jo-qarkulluese		133,097	135,710
Asetet qarkulluese			
Stoqet	9	5,016	4,733
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	10	17,827	21,902
Parapagesat ndaj autoriteteve tatimore	21	-	21,463
Tatimi në fitim i arkëtueshëm		3,108	-
Shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera	11	3,801	1,786
Investimet afatshkurtëra financiare	12	169,913	42,871
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	12	79,131	179,870
Totali i aseteve qarkulluese		278,796	272,625
Totali i aseteve		411,893	408,335
EKUITETI			
Kapitali i emetuar	13	260,000	260,000
Fitimet e mbajtura		134,434	86,399
Totali i ekuitetit		394,434	346,399
DETYRIMET			
Llogaritë e pagueshme tregtare	14	7,107	7,834
Detyrimet për obligimet e pensionit plotësues	25	-	1,469
Tatimi në fitim i pagueshëm	21	-	38,203
Akrualet dhe të pagueshmet tjera	15	7,818	10,801
Të ardhurat e shtyra	16	2,534	3,629
Totali i detyrimeve rrjedhëse		17,459	61,936
Totali i detyrimeve		17,459	61,936
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve		411,893	408,335


Bilanci i konsoliduar i gjendjes duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 35 që janë pjese përbëre e pasqyrave të konsoliduara financiare.

Bordi i Drejtorëve i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Holding Sh.a. ka autorizuar lëshimin e këtyre pasqyrave financiare më 16 Qershor 2009. Janë nënshkruar në emër të tij nga:

z. Rexhë Gjonablaj
Kryetar i Bordit



z. Dr. Shyqyri Haxha
Kryeshf Ekzekutiv



për **Zyrtar Kryesor Financiar**



Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008

(në mijë Euro)

	Shënimi	31 Dhjetor 2008	31 Dhjetor 2007
Të ardhurat	17	161,481	182,463
Të hyrat tjera		17	203
Kostot operacionale	18	(23,993)	(20,119)
Kostot e stafit	19	(34,071)	(31,883)
Zhvlersimi	6	(13,300)	(21,911)
Amortizimi	7	(4,192)	(3,172)
Humbja nga dëmtimi i bilanceve bankare		813	850
Kosotot tjera	20	(16,575)	(17,096)
Të hyrat e interest	12	10,651	8,370
Fitimi përpara tatimit		80,831	97,705
Shpenzimi i tatimit në fitim	21	(20,706)	(47,368)
Fitimi neto për vitin		60,125	50,337

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 35 që janë pjëse përbëre e pasqyrave të konsoliduara financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008
(në mijë Euro)

	Shënimi	Kapitali i emetuar	Fitimet e mbajtura	Totali
Bilanci më 1 Janar 2007		260,000	66,062	326,062
Dividendat e aksionarëve	13	-	(30,000)	(30,000)
Rregullimet e vitit paraprak				
Fitimi për vitin		-	50,337	50,337
Bilanci më 31 dhjetor 2007	13	260,000	86,399	346,399
Bilanci më 1 janar 2008		260,000	86,399	346,399
(Humbjet) e njohura në ekuitet	13	-	(12,090)	(12,090)
Fitimi për vitin		-	60,125	60,125
Bilanci më 31 dhjetor 2008	13	260,000	134,434	394,434

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve ne ekuite duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 35 që janë pjëse përbëre e pasqyrave të konsoliduara financiare.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Parasë
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro)

	Shënimi	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi për periudhën		60,125	50,337
<i>Rregulluar për:</i>			
Zhvlersimin	6	13,300	21,911
Amortizimin	7	4,192	3,172
Humbjet/(kthimet) e dëmtimit në vlerë – borxhet e dyshimta	10	5,188	4,875
Humbjet/(kthimet) e dëmtimit në vlerë – depozitat bankare	12	(813)	(850)
Të hyrat e interesit	12	(10,651)	(8,370)
Shpenzimi aktual i tatimit në fitim	21	16,779	22,062
Shpenzimi/(të hyrat) e tatimit të shtyrë (Humbjet) e njohura në ekuitet	8	3,927	(1,168)
Tatimi shtesë në fitimin neto	21	-	26,474
		79,958	118,443
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin punues dhe provione			
Garanci dalje për Monaco Telecom International		2,000	-
Ndryshimet në stoqe		(283)	709
Ndryshimet në llogaritë e të arkëtueshmeve tregtare		(1,113)	(5,785)
Ndryshimet në shpenzimet e parapaguara dhe të arkëtueshmet tjera		(77)	(1,977)
Ndryshimet në llogaritë e të arkëtueshmeve		(727)	150
Ndryshimet në akruale dhe të pagueshme tjera		(2,983)	965
Ndryshimet në të ardhurat e shtyera		(1,095)	(214)
Ndryshimet në detyrimet për obligimet e pensionit plotësues	25	(1,469)	(98)
		74,211	112,195
Paratë e gjeneruara nga operimet			
Tatimi në fitim i paguar		21,463	(41,210)
Paguar autoritetit tatimor për kontestet		(58,091)	-
Dividentat e paguara		-	(30,000)
		37,583	40,985
Rrjedha parasë nga aktivitet investuese			
Interesi i arkëtuar			
Pagesat për blerjen e tokës, impianteve dhe pasijeve		(18,715)	(15,689)
Shumat nga shitja e pronës, impianteve dhe paisjeve		-	-
Blerja e pasurive të patrupëzuara		(7,346)	(7,510)
Investimet neto në depozitat bankare		(120,974)	114,133
		(138,322)	101,230
Paratë neto të gjeneruara nga/(përdorur në) aktivite investuese			
Ndryshimi neto në para dhe ekuivalente të parasë		(100,739)	142,215
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 janar		179,870	37,655
	12	79,131	179,870
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 31 dhjetor			

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

1. HYRJE

Historiku i Grupit

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a. ("PT Holding", ose "Grupi") është Grup me vendndodhje në Kosovë.

PTK Holding është kompani aksionare e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve në Kosovë me Nr.70279297.

Adresa e regjistruar e PTK Holding dhe vendi kryesor i biznesit është Rruga Dardania, Prishtinë, Kosovë.

PTK Holding është aksionare 100% e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës Sh.a. ("PTK").

Pronari kryesor i PTK Holding është Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM). AKM-ja është themeluar në Korrik 2002 për të vepruar si administruese për pronarët dhe kreditorët e të gjitha ndërmarrjeve publike dhe pasurive të tyre në Kosovë.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/12 qartëson që e drejta për të operuar shërbimet postare dhe të telekomunikacionit në Kosovë i është dhënë ndërmarrjes publike Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës ("ndërmarrja PTK"), ndërmarrje kjo jo e korporatizuar e themeluar nga i njëjti rregullator. Gjatë periudhës ndërmjet tetorit 1999 dhe qershorit 2005, shërbimet e postës dhe telekomunikacionit në Kosovë janë ofruar nga ndërmarrja PTK dhe pas korporatizimit, nga PTK-ja.

Më 13 qershor 2008 duke u bazuar në Nenin 65(1) të Kushtetutës së republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës bëhet aksionari i ri i Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës.

Korporatizimi

Ndërmarrja PTK ka qënë një ndërmarrje sipas kuptimit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 "Mbi themelimin e Agjensisë Kosovare të Mirëbesimit". Rregullorja 2005/18 i ka dhënë AKM-së autoritetin për të transformuar ndërmarrjet në korporata. Në takimin e datës 9 maj 2005, Bordi i Drejtorëve i AKM-së ka vendosur të transformojë ndërmarrjen PTK në shoqëri aksionare, të quajtur Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a. Në datën e korporatizimit më 22 qershor 2005, PTK holding në mënyrë efektive zëvendëson "ndërmarrjen" e mëparshme që kryente biznes si "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës" në baza vazhdimësie, pa likuidim. Ndërmarrja PTK është ndërmarrja e parë që është transformuar në Korporatë nën rregulloren e AKM-së dhe Udhëzimin Administrativ 2005/6. AKM-ja, që vepron si administrator i besuar për pronarët kryesor të ndërmarrjeve të Kosovës bazur në rregulloren e AKM-së, është aksionari aktual i 100% të aksioneve të PTK Holding. Kapitali i emetuar aksionar në korporatizim shënon 260 milion Euro.

Menjëherë pas korporatizimit. PTK Holding ka formuar një Grup operativ, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.a. ("PTK") dhe ka transferuar disa nga pasuritë e saj tek PTK në formë të kontributit capital. PTK Holding ka në pronësi 100% të PTK-së.

PTK Holding mbajti disa nga asetet e ndërmarrjes PTK si dhe të gjitha detyrimet e njohura dhe të panjohura që kishte deri më 30 qershor 2005, dhe PTK-ja ka të drejtën të dëmshpërblehet nga PTK Holding në rast se ndonjë palë e tretë vë kërkesë kundër PTK-së në lidhje me detyrimet e mbajtura nga PTK Holding.

Asetet operative të ndërmarrjes PTK, përfshirë Liçensat e Telefonisë Fikse, Liçensat e Telefonisë Mobile dhe ISP të transferuara te PTK, nga PTK Holding, dhe për pasojë PTK-ja është entiteti i vetëm që në mënyrë të ligjshme ofron shërbime të telekomunikacionit dhe postare në Kosovë. PTK-ja aktualisht është e organizuar në katën njësi biznesore: (I)njësia biznesore e telefonisë fikse, (II) njësia biznesore e telekomunikacionit mobil, (III) njësia biznesore e shërbimit të internetit, dhe (IV) njësia biznesore e postës. Veç kësaj, PTK-ja ka edhe njësitë mbështetëse të cilat ndihmojnë në funksionimin e njësive biznesore.

PTK Holding dhe PTK-së së bashku u referohen si "Grupi". Kapitali i regjistruar i vartësit të zotëruar në tërësi është 250 milion Euro, dhe aksionet e vartësit janë emetuar në këmbim për asetet e caktuara neto të kontribuara nga PTK Holding. Duke pasur parasysh efektin praktik të transformimit dhe korporatizimit, Administrata Tatimore ka aprovuar procesin ristrukturues të ndërmarrjes PTK-së si një "riorganizim" për qëllime të Nenit 24.1. të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/51 "Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave".

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

1. HYRJE (vazhdim)

Më 13.06.2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovoi Ligjin mbi Ndërmarrjet SHOQËRORE (Ligji Nr. 03/L-087), dhe duke u bazuar në nenin 3 të këtij Ligji, ndërmarrjet shoqërore përfshirë PTK Sh.a. janë shpallur si pasuri të Republikës së Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës ka përmes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave autoritetin ekskluziv që të ushtrojë të drejtat e aksionarit mbi ndërmarrjet shoqërore.

Aktivitetet biznesore

Më 31 dhjetor 2008, Grupi ka tri njësi biznesore, dy nga të cilat janë të licensuara nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit në Kosovë ("ART"), një prej tyre është gjithashtu e autorizuar nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit:

Njësia Postare ("Posta")

Autoriteti i Bankave dhe Pagesave të Kosovës ("BPK") i ka lëshuar PTK-së licencën financiare jo-bankare e cila i mundëson Postës ofrimin e pagesave në para të gatshme dhe faturimin për palëve të treta. Ndërsa më 15 maj 2006, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit i ka lëshuar PTK-së licencën për ofrimin e shërbimeve postare universale.

Njësia e Telefonisë Fikse ("Telefonia Fikse")

Njësia e Telefonisë Fikse është i vetmi ofrues i licencuar i shërbimeve të telefonisë fikse për konsumatorët individual dhe të biznesit në territorin e Kosovës. Njësia e telefonisë fikse gjithashtu ka ofruar shërbime të internetit që nga viti 2001, dhe ajo sot është një nga tre operatorët e autorizuar nga ART-ja, që ofrojnë shërbime të internetit në Kosovë.

Njësia e telefonisë ("Vala 900")

Vala 900 është njësia operuese e telefonisë mobile GSM dhe aktualisht është njëri nga dy rrjetet e licensuara dhe ofrues i shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë.

Aktualisht shërbimet e Valës mbulojnë afër 90% të territorit gjeografik dhe më shumë se 85% të popullsisë së Kosovës. Në vitin 2005, faza 4 e planifikuar për punët teknike ka filluar dhe pasi që ajo të jetë kompletuar, shërbimi/rrjeti i Valës 900 do të mbulojë afërsisht 99% të popullsisë së Kosovës.

Ndërmarrja e PTK-së në vitin 2000 arriti një marrëveshje me "Monaco Telecom International" ("MTI") për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë ku kjo marrëveshje i jep të drejtë PTK-së të përdorë kodin internacional të MTI-së, i cili i mundëson rrjetit mobil të PTK-së lidhje me rrjetet ndërkombëtare. Si element i kësaj marrëveshjeje, PTK-ja i kompenson MTI-së një pjesë të të hyrave dhe pagesë të disa shpenzimeve të trafikut ndërkombëtar. Gjatë vitit 2006, kontrata ndërmjet MTI dhe PTK SH.A. ishte rinegociuar dhe ndryshuar. Kontrata e re kornizë përfshin përdorimin e kodit të thirrjeve të Monaco International, trafikun ndërkombëtar, roaming dhe transferimin njohurive teknike. Përveç kësaj, kontrata e re kornizë përfshin edhe dispozitën për shkëputjen e kontratës nëse Kosova e siguron/merr kodin e vet ndërkombëtar të thirrjeve.

Në fund më 31 dhjetor 2008 Grupi ka 2,556 të punësuar (2007: 2,514).

2. BAZA E PËRGATITJES

(a) Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

(b) Baza e matjes

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përgatitur sipas parimit të kosotos historike përveq për disa instrumente financiare derivative (nëse ka), instrumente financiare në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, dhe asetëve financiare të gatshme për shtitje, të cilat janë matur në vlerë reale.

Metodat e përdorura për të matur vlerat reale për qëllime të shpalsojes janë treguar më poshtë në shënimin 4.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (vazhdim)

(c) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë prezantuar në Euro, që është monedha/valuta funksionale e PTK Holding dhe PTK-së. Të gjitha informatat financiare të raportuara në Euro, janë rrumbullakuar në mijëshen me të përafërt.

(d) Përdorimi i vlersimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave të kontabilitetit dhe shumat e raportuara të asetëve, detyrimeve, të hyrave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlersimet dhe supozimet e ndërlidhura janë rishikuar vazhdimisht. Rishikimet e vlersimeve të kontabilitetit janë njohur në periudhën në të cilën këto vlersime janë rishikuar dhe në ndonjë periudhë pasuese që preket nga ato.

Veçanërisht, informacioni mbi fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlersimit dhe gjykimet kritike në aplikimin e politikave të kontabilitetit që kanë ndikimin më të madh në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë përshkruar në shënimin 28 – Vlersimet dhe gjykimet e kontabilitetit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura në vazhdim janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra të konsoliduara financiare. Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në vazhdimësi nga Grupi dhe vartësja e tij PTK Sh.a.

Pasqyrat e konsoliduara të kontabilitetit janë përgatitur për vitet e përfunduar më 31 dhjetor 2008 dhe 2007.

Interpretimet efektive në vitin 2008

- KINRF 11 - SNRF 2 – Transaksionet e aksioneve të grupit dhe thesarit, ofrojnë udhëzim mbi atë se nëse transaksionet e bazuara në aksione që përfshijnë aksione të thesarit ose që përfshijnë entitete grupore (për shembull, opsionet mbi aksionet amë) duhet të trajtohen si transaksione të pagesave të bazuara në aksione e që shlyhen me ekuitet apo si transaksione të pagesave të bazuara në aksione e që shlyhen me para në llogari të veqanta të kompanive amë apo grupore. Ky interpretim nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të Grupit.
- KINRF 12 – Marrëveshjet koncesionare të shërbimit, aplikohen te marrëveshjet kontraktuale aty ku operatori i sektorit privat merr pjesë në zhvillimin, financimin, operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës për shërbime të sektorit publik. KINRF 12 nuk është relevant për operimet e Kompanisë pasi që nuk ofron shërbime për sektorin publik.
- KINRF 13 – Programet e besnikërisë së konsumatorit, qartëson se ku mallrat dhe shërbimet shiten së bashku me stimulim për besnikëri të konsumatorit (për shembull, pikë të besnikërisë apo produkte falas), marrëveshja është një marrëveshje shumë elementëshe dhe e arkëtueshmja e shpërblimit nga konsumatori ndahet ndërmjet elementëve të marrëveshjes në përdorimin e vlerave reale. KINRF 13 nuk është relevant për operimet e Grupit sepse Grupi nuk operon ndonjë program të besnikërisë.
- KINRF 14 - SNK 19 – Limiti mbi asetin me benefit të definuar, kërkesat minimale të financimit dhe bashkveprimi i tyre, ofron udhëzim mbi vlersimin e limitit në SNK 19 për shumën e tepërisë që mund të njihet si aset, gjithashtu shpjegon se si asetet e pensionit ose detyrimet mund të ndikohen nga kërkesa minimale, ligjore apo kontraktuale, të financimit. Ky interpretim nuk është relevant për operimet e Grupit sepse Grupi nuk operon ndonjë aset me benefit të definuar.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe që nuk janë adoptuar më herët nga Grupi

Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese në vazhdim janë publikuar dhe janë të detyrueshme për Kompaninë për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2009 apo edhe periudha të mëvonshme, por që Grupi më herët nuk i ka adoptuar ato.

- SNRF 8 – Segmentet Operuese (efektiv prej 1 Janar 2009), paraqet “çasjen menaxheriale” në raportimin si segment, nën të cilën informacioni segment paraqitet në të njëjtën bazë si ai i përdorur për qëllime të raportimit të brendshëm. Adoptimi i këtij standardi nuk do të ketë efekt në fitimin apo humbje apo ekuitetin e raportuar të Grupit.

Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe që nuk janë adoptuar më herët nga Grupi (vazhdim)

- SNR 1 (Rishikim) – Prezantimi i pasqyrave financiare (efektiv prej 1 Janarit 2009). Standardi i rishikuar do të ndalojë prezantimin e zërave të të hyrave dhe shpenzimeve (që janë, “ndryshime jo të pronarit në ekuitet”) në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, ku kërkon që “ndryshimet jo të pronarit në ekuite” të paraqiten ndaras nga ndryshimet e pronarit në ekuitet. Të gjitha ndryshimet jo nga pronari në ekuitet do të kërkohej të tregohen në pasqyrën e performancës, por entitetet mund të zhgjedhin nëse do të prezantojnë një pasqyrë të ekzekutimit (pasqyrën gjithpërfshirëse të të ardhurave) apo dy pasqyra (pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën gjithpërfshirëse të të ardhurave). Kur entitetet ripasqyrojnë apo riklasifikojnë informatat gjithpërfshirëse, nga ato do të kërkohej të paraqesin bilancin e ripasqyruar të gjendjes në fillim të periudhës krahasuese përveq kërkesës aktuale për të paraqitur bilancin e gjendjes në fund të periudhës aktuale dhe krahasuese. Grupi do të zbatojë SNK 1(Rishikim) prej 1 Janarit 2009. Është e mundur që të dyja edhe pasqyra e të ardhurave si dhe pasqyra gjithpërfshirëse e të ardhurave të paraqiten si pasqyra të performancës.
- SNR 23 Kostot e Huazimit (Rishikim) (efektiv prej 1 Janarit 2009). Standardi i rishikuar heq opsionin e shpenzimit të kostove të huazimit dhe kërkon që një entitet të kapitalizojë kostot e huazimit direkt të atribueshme në blerje, ndërtim apo prodhim të asetit të kualifikuar si pjesë të kostos së asetit. Në pajtueshmëri me kërkesat kalimtare, Grupi do të aplikojë SNK 23 të rishikuar në asetet kualifikuese për të cilat kapitalizimi i kostove të huazimit fillon në apo pas datës efektive. Prandaj nuk do të ketë ndikim në periudhat e mëparshme të pasqyrave financiare të Grupit për vitin 2009.
- SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Rishikim 2008) (efektiv prej 1 Korrikut 2009). Standardi është i aplikueshëm për kombinimet e biznesit që kanë ndodhur në periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Korrikut 2009 dhe do të aplikohet në vazhdimësi. Standardi i ri prezanton ndryshimet në kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit, por që ende kërkon përdorimin e metodës së blerjes, dhe do të ketë efekt të rëndësishëm në kombinimet e biznesit që do të ndodhin në periudhat raportuese që fillojnë më ose pas 1 Korrikut 2009
- SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të ndara (Rishikim 2008) (efektiv prej 1 Korrikut 2009). Standardi i rishikuar prezanton ndryshimet e kërkesave të kontabilitetit për humbjen e kontrollit të njërive vartësve dhe për ndryshimet në interesin e Grupit në njësitë vartëse. Menaxhmenti nuk pret që standardi do të ketë efekt material në pasqyrat financiare të Grupit.
- Amendamentet e SNRF 2 Pagesat me bazë në aksion (efektiv prej 1 Janarit 2009). BSNK ka nxjerrë një amendament për SNRF 2 në lidhje me kushtet e performancës (vesting conditions) dhe anulimet. Menaxhmenti nuk mendon se amendamentet do të kenë ndikim në politikat e kontabilitetit të Grupit pasi që Grupi nuk operon ndonjë skemë të pagesës me bazë aksionin.
- Përmirsimet vjetore 2008. BSNK ka nxjerrë Përmirsimet për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar 2008. Shumica e këtyre amendamenteve janë efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2009. Grupi nuk mendon se këto amendamente do të kenë ndikim të dallueshëm në pasqyrat financiare të Grupit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

(a) Baza e konsolidimit

Këto pasqyra të konsoliduara financiare përfshijnë PTK Holding dhe vartësen e saj PTK-në. Një vartësë është entiteti i kontrolluar nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Kompania ka fuqinë që, direkt ose indirekt, të drejtojë politikat financiare dhe operuese të një entiteti në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Pasqyrat financiare të degëve janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të këtij kontrolli deri në datën e përfundimit të tij.

Bilancat brenda grupit dhe ndonjë fitim apo humbje e përealizuar ose ndonjë shpenzim dhe e ardhur që rrjedh nga veprimet brenda grupit, eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara.

Në mungesë të udhëzimeve më specifike në SNRF, Grupi aplikon metodën e matjes së vlerës së librit në themelimin e vartëses në vitin 2005. Asetet e transferuara në rastin e këmbimit të aksioneve janë në përgjithësi asete operacionale të PTK-së, të cilat i ka identifikuar PTK Holding dhe të cilat mund të kishte çasje në kohën e transformimit. Llogaritë e arkëtueshme të PTK Holding, asetet të cilat nuk janë më operative ose që nuk janë më në çasje të PTK Holding, dhe detyrimet e PTK Holding, kanë mbetur tek PTK Holding së bashku me një sasi të caktuar të parasë për të mbuluar detyrimet që kanë mbetur në PTK Holding.

(b) Valuta e huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit që është në datat e transaksioneve. Asetet monetare dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit janë kthyer përsëri në valutën funksionale me normën e këmbimit në atë datë. Fitimi dhe humbja e valutës së huaj mbi zërat monetar është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në valutën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në valutën e huaj të kthyer në normën e këmbimit në fund të periudhës. Asetet jo-monetare dhe detyrimet në valuta të huaja që janë matur në vlerë reale janë kthyer në valutën funksionale me normën e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera reale. Ndryshimet e valutës së huaj që dalin nga kthimet janë njohur në fitim apo humbje, përveq për diferencat që dalin nga rikthimi i instrumenteve të ekuitetit të gatshme për shitje (nëse ka).

(c) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare jo-derivative të Grupit përfshijnë të arkëtueshmet tregtare, paranë dhe ekuivalentet e parasë, dhe të pagueshmet tregtare e të tjera. Gjatë periudhave raportuese nuk ka instrumente në ekuitet, letra me vlerë të borxhit dhe kredit e huazime të përdorura gjatë rrjedhës së aktiviteteve.

Instrumentet financiare jo-derivative janë njohur fillimisht në vlerë reale plus, për instrumentet që nuk janë në vlerë reale përmes fitimit apo humbjes, ndonjë kosto të transaksionit që ngarkohet drejtpërdrejtë, prveq siq është përshkruar më poshtë. Pas njohjes fillestare instrumentet financiare jo-derivative janë matur siq është përshkruar më poshtë.

Një mjet financiar është njohur nëse Grupi bëhet palë e dispozitave kontraktuale e instrumentit. Asetet financiare nuk janë njohur nëse të drejtat kontraktuale të Grupit për rrjedhat e parasë nga asetet financiare kanë skaduar ose nëse Grupi transferon asetin financiar te një palë tjetër pa mbajtur kontrollin apo të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e asetit. Blerjet dhe shitjet normale të aseteve financiare janë regjistruar në datën e tregëtimit, d.m.th. në datën në të cilin Grupi zotohet të blejë apo shesë asetin. Detyrimet financiare janë hequr nëse obligimet e Grupit të specifikuara në kontratë skadojnë ose janë hequr apo anuluar.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parasë së gatshme, llogaritë rrjedhës bankare dhe depozitat afatshkurtëra bankare. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë depozitat e pakufizuara me maturitet prej tre muajsh apo më pak që nga data e origjinës.

Depozitat afatshkurtëra me maturitet që qëndron ndërmjet 3 dhe 12 muajsh, ashtu si depozitat bankare agatgjata me maturitet që qëndron në më shumë se 12 muaj, janë instrumente financiare të mbajtura deri në maturitet, dhe janë bartur në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus humbjet nga dëmtimi në vlerë. Ato nuk trajtohen si para dhe ekuivalente të parasë.

Llogaritë e të arkëtueshmeve tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë njohur fillimisht në vlerë reale dhe më pas janë matur në koston e tyre të amortizuar minus humbjet e dëmtimit në vlerë.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera janë dhënë në vlerë reale dhe më pas në koston e tyre të amortizuar.

Të tjera

Instrumentet tjera jo-derivative janë matur në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë humbje e dëmtimit në vlerë.

Kapitali aksionar dhe fitimet e mbajtura

(I) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(II) Kosoto e emetimit të aksioneve

Kstot instrumentale që janë direkt të ngarkuara në emetimin e aksioneve ose opsioneve të reja ose në blerjen e një biznesi janë treguar në ekuitet si deduksion, neto e tatimit, nga shumat e pranuar.

(III) Aksionet e thesarit

Ay ku Grupi blen kapital aksionar, shuma e paguar është deduktuar nga totali i ekuitetit aksionar si aksione të thesarit deri sa ato janë mbyllur. Aty ku këto aksione janë shitur më pas ose rriemtuar, ndonjë shumë e pranuar është përfshirë në ekuitet aksionar.

(IV) Fitimet e mbajtura

Fitimet e mbajtura përbëhen nga fitimet e pashpërndara nga periudhat ektuale dhe të kaluara.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

d) Prona, impiantet dhe paisjet

(I) Njohja dhe matja

Artikujt e pronës, impianteve dhe paisjeve janë matur në kosto (ose kosto të vlersuar) minus zhvlersimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë.

Disa artikuj të pronës, impianteve dhe paisjeve që janë rivlersuar më 1 janr 2005. datë e kalimit tek SNRF-të, me vlerë reale në lidhje me korporatizimin e filluar të PTK Holding, janë matur në bazë të koston së vlersuar, duke qënë shuma e rivlersuar në datën e atij rivlersimi.

Kostoja përshinë shpenzimet që janë direkt të ngarkuara në blerje të asetit. Kostoja e aseteve të vetëndërtuara përfshinë koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që është direkt e ngarkuar në sjelljen e asetit në gjendje punë për qëllimin e menduar, dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së artikullit dhe rregullimin e vendit ku janë vendosur. Shpenzimet kapitale mbi asetet gjatë ndërtimit janë bartur tek Asetet në ndërtim dhe janë kapitalizuar e transferuar në kategorinë e duhur të asetit atëherë kur përfundohen, prej ku fillon aplikimi i zhvlersimit në normën e aplikueshme ndaj kategorisë në fjalë.

Kur pjesët e një artikulli të pronës, impianteve dhe paisjeve kanë kohë të ndryshme të përdorimit, ato janë regjistruar si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe paisjeve.

(II) Kostot pasuese

Kostoja e zëvendësimit së një pjesë të pronës, impianteve dhe paisjeve është njohur në vlerën bartëse të artikullit nëse është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në Grup dhe kostoja e tyre të mund të matet me bësueshmëri. Kostot e servisimeve të përditshme të pronës, impianteve dhe paisjeve janë njohur në fitim apo humbje atëherë kur kanë ndodhur.

Fitimet apo humbjet e nxjerrjes jashtë përdorimit të pronës, impianteve dhe paisjeve janë përcaktuar duke u referuar në vlerën e tyre bartëse dhe janë marrë parasysht në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

(III) Zhvlersimi

Zhvlersimi është njohur në fitim apo humbje në bazë lineare përgjatë kohës së vlersuar të përdorimit të secilës pjesë të një artikulli të pronës, impianteve dhe paisjeve. Toka dhe pasuritë në ndërtim nuk janë zhvlersuar. Kohët e vlersuara të përdorimit për klasat madhore të pasurive janë si në vazhdim (si për vitin 2008 edhe 2007):

• Ndërtesat (nga data e vlersimit)	20 vite
• Zyrat postare (strukturë druri)	10 vite
• Linjat e rrjetit	20 vite
• Kanalet kablloviqe dhe shtyllat e antenave	20 vite
• Stacionet Bazë	5 vite
• Makineria dhe paisjet	5 deri 10 vite

Kohët e përdorimit, metodat e zhvlersimit dhe vlerat e mbetura, nëse kanë qënë të rëndësishme, të pronës, impianteve dhe paisjeve janë ripasqyruar në datën e raportimit

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETI (vazhdim)

e) Asetet e patrupëzuara

(I) Njohja dhe matja

Asetet e patrupëzuara janë matur në kosto minus zhvlersimi i akumuluar dhe dëmtimi i akumuluar në vlerë, nëse ka.

(II) Shpenzimet pasuese

Shpenzimi pasues është kapitalizuar vetëm kur rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në asetin specific me të cilin ndërlidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për zërin e mirë dhe brendet e gjeneruara në mënyrë interne, është njohur në fitim dhe humbje kur ka ndodhur.

(III) Amortizimi

Amortizimi është njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë kohës së vlersuar të përdorimit të aseteve të patrupëzuara nga data kur ato janë të gatshme për përdorim. Kohët e vlersuara të përdorimit janë në vazhdim (për vitin 2008 dhe 2007):

- | | |
|--------------------------|---------|
| • Programet kompjuterike | 5 vite |
| • Liçensat e telekomit | 15 vite |

f) Inventari

Invetari është dhënë në koston më të ulët dhe vlerën e realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlersuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kosot e vlersuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostoja përfshin shpenzimin e shkaktuar në blerjen e inventarit dhe sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen egzistuese.

Kostoja e inventarit të konsumuar është bazuar në formulën e mesatares së ponderuar.

g) Dëmtimi në vlerë

(I) Asetet financiare

një asset financiar është menduar si i dëmtuar nëse dëshmie objektive tregon se një apo më shumë ngjarje kanë ndikim negativ në rrjedhat e ardhshme të vlersuara të parasë për asetin.

Një humbje e dëmtimit në vlerë sa i përket asetit financiar të matur në kosto të amortizuar është llogaritur si ndryshim ndërmjet vlerës bartëse, dhe vlerës aktuale të rrjedhave të vlersuara të parasë gjatë të ardhmes të aktulizuara në normës efektive origjinale të interesit. Një humbje e dëmtimit në vlerë sa i përket një aseti financiar të gatshëm për shitje është llogaritur duke u referuar në vlerën e tij reale që është aktualisht.

Asetet financiare të rëndësishme janë testuar për dëmtim në baza individuale. Asetet financiare të mbetura, të tilla si të arkëtueshmet tregtare nga klientët post-paid të ndërlidhur me rrjetet fikse dhe mobile, janë vlersuar në mënyrë kolektive në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet e dëmtimit janë njohur në fitim apo humbje. Ndonjë humbje e akumuluar sa i përket një aseti financiar të gatshëm për shitje që më parë është njohur në ekuitet është transferuar në fitim dhe humbje. Një humbje e dëmtimit është kthyer mbrapsht nëse ky kthim mund të ndërlidhet me një ngjarje që ka ndodhur pasi që është njohur humbja e dëmtimit. Për asetet financiare të matura në koston të amortizuar kthimi është njohur në fitim apo humbje.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETI (vazhdim)

(II) Asetet jo-financiare

Vlerat bartëse të aseteve jo-financiare të Grupit, përveq inventarit dhe aseteve të tatimit të shtyrë janë rishikuar në secilën datë të raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion për dëmtim. Nëse një indikacion i tillë ekziston atëherë shuma e rikuperueshme e asetit është vlersuar.

Një humbje e dëmtimit është njohur nëse vlera bartëse e një asetit ose e njësisë së tij të gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Humbjet e dëmtimit janë njohur në fitim apo humbje.

h) Përfitimet e të punësuarve

Pensionet e detyrueshme

Grupi, përgjatë rrjedhës normale të biznesit, kryen pagesa në emër të tij dhe në emër të të punësuarve të tij për të kontribuar në pensionin e detyrueshëm në pajtueshmëri me legjislacionin vendor. Kostot e pësura në emër të grupit janë ngarkuar në fitim dhe humbje kur kanë ndodhur.

Obligimet e definuara të përfitimit të pensionit

Grupi ka vendosur të ofrojë Pension Suplementar të të Punësuarve përmes themelimit të "Fondit Pensional të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës". Fondi pensional ka operuar në mënyrë efektive prej 1 janarit 2003 si entitet i pavarur jo-fitimprurës, deri më 31 dhjetor 2005 kur është mbyllur me vendim të Bordit të Drejtorëve të PTK-së dhe PTK Holding. Fondi ka identifikuar dy kategori të përfituesve të identifikuar në Shtojcën A dhe B. Shtojca A ka siguruar pensione për ish-punonjësit e PTK-së të cilët janë larguar përpara themelimit të Fondit Pensional të PTK-së, ose përfituesit e këtyre punonjësve që tashmë marrin pensione në pajtueshmëri me marrëveshjet e mëparshme të përfitimit. Shtojca B ka siguruar pension me përfitim të definuar për të gjithë të punësuarit që plotësojnë kërkesat, si punonjësit actual ashtu edhe ata të mëparshëm.

Zotimi fillestar i Grupit ishte të paguante 10.1% të pagave bruto Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës. Kjo skemë pensionale është suplementare dhe si e tillë e ndarë nga fondi pensinal Shtetëror.

Obligimi neto i Grupit në lidhje me planin pensional të definuar të përfitimit, Shtojca A dhe B, është llogaritur ndaras për secilën skemë duke vlersuar shumën e përfitimit të ardhshëm që të punësuarit kanë fituar në këmbim të shërbimeve të tyre në periudhat aktuale dhe të mëparshme; ky përfitim skontohej për të përcaktuar vlerën e tij aktuale, dhe ndonjë kosto e panjohur e shërbimit të mëparshëm dhe vlera reale e ndonjë asetit të planit janë zbritur. Norma e skontimit është vlera në datën e raportimit në obligacionet e kualitetit të lartë që janë në dispozicion në Kosovë dhe që kanë data të maturitetit që përafrojnë afatet e obligimeve të Grupit (d.m.th. Obligacionet 10 vjeçare në Gjermani me një vlerë 3.75% më 9 nëntor 2006). Llogaritja në datën e përfundimit është kryer nga një aktuar i kualifikuar duke përdorur metodën e projektuar të kreditimit të njësisë.

Përfitimet afatshkurtëra

Obligimet e përfitimeve afatshkurtëra të punonjësve janë matur në bazë jo-të skontueshme dhe janë shpenzuar pasi që shërbimi i ndërlidhur të jetë ofruar. Provisioni është njohur për shumën që pritet të paguhet sipas bonusi afatshkurtër në para nëse Grupi ka një obligim të tanishëm ligjor apo të tërthortë për të paguar shumën si rezultat i shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punonjësi dhe obligimi të mund të vlersohet me besueshmëri.

i) Provizionet

Provizioni është njohur nëse, si rezultat i ngjareve në të kaluarën, grupi ka obligim të tanishëm apo të tërthortë ligjor i cili mund të vlersohet me besueshmëri, dhe është e mundur që do të nevojitet një rrjedhje e parasë ën ardhmen për të shlyer obligimin. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar rrjedhat e pritshme të parasë në të ardhmen me normën përpara tatimit që reflekton vlersimet aktuale të tregut për vlerën kohorë të parasë si dhe rreziqet specifike ndaj detyrimit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETI (vazhdim)

j) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga telefonia mobile

Të ardhurat nga shërbimet e telefonisë mobile nga kartat parapaguese me gërvishje dhe Sim kartat janë njohur duke u bazur në përdorim. Koha e pashfrytëzuar për bisedë është përfshirë në "Të hyrat e shtyera" në bilan të gjendjes. Pas skadimit të kartave gërvishëse me parapagim, koha e mbetur e pashfrytëzuar është njohur si e hyrë.

Të ardhurat nga komunikimi me kontratë (post paid) janë njohur duke u bazur në kohën aktuale të gjeneruar të bisedës nga telefonuesi në periudhën aktuale.

Të ardhurat nga roamingu ndërkombëtar (international roaming air time) janë njohur në bazë të minutave të shfrytëzuar në pajtueshmëri me raportet periodike financiare të ofruara nga ofruesi i shërbimit të rrjetit, Monaco Telecom International.

Të ardhurat nga linja fikse

Të ardhurat nga linja fikse janë njohur në bazë të minutave të ndërlidhur me periudhën aktuale.

Të ardhurat nga shërbimi i internetit

Të ardhurat nga shërbimet e internetit janë njohur në bazë lineare përgjatë periudhës së abonimit të konsumatorit.

Të ardhurat tjera

Të ardhurat nga shitja e mallrave janë njohur në pasqyrën e të ardhurave kur rreziqet e rëndësishme dhe shpërblimet e pronësisë i janë transferuar blerësit. Të ardhurat nga shërbimet e ofruara janë njohur në pasqyrën e të ardhurave në proporcion me fazën e kompletimit të transaksionit në datën e bilancit të gjendjes.

k) Shpenzimet

Komisioni i detyruar ndaj Monaco Telecom International

Kostot e komisionit ndaj Monaco Telecom International janë njohur në bazë akruale kur kanë ndodhur.

Pagesat e qerasë operationale

Pagesat e kryera nën qeranë operationale janë njohur në fitim dhe humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qerasë. Stimujt e pranuar të qerasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qerasë, përgjatë afatit të qerasë.

l) Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi fondet e investuara në depozita bankare, fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aseteve financiare të gatshme për shitje, dhe fitimet e valutës së huaj. Të ardhurat e interesit janë njohur gjatë rritjes, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet e valutës së huaj, lëshimet e skontimit të provizioneve, nëse janë materiale, dhe humbjet e dëmtimit në vlerë të njohura në asetet financiare.

m) Shpenzimi i tatimit në fitim

Shpenzimi i tatimit në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Shpenzimi i tatimit në fitim është njohur në fitim dhe humbje përveq rasteve që ndërlidhen me artikujt e njohur direkt në ekuitet, ku në atë rast edhe tatimit është njohur në ekuitet.

Tatimi aktual është tatimi që pritet për t'u paguar mbi të hyrat e tatueshme për vitin i llogaritur në pajtueshmëri me direktivën e administratës së UNMIK-ut të aplikueshme për periudhën në fjalë, duke përdorur normat e miratuar në datën e bilancit të gjendjes apo të miratur më pas, si dhe ndonjë rregullim në tatimin e pagueshëm në lidhje me vitin paraprak.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETI (vazhdim)

Tatimi i shtyrë është njohur duke përdorur metodën e bilancit të gjendjes, duke sjellë diferencë të përkohshme ndërmjet vlerave bartëse të aseteve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë nuk është njohur për diferencët epërkohshme në vazhdim: njohja fillestare e zërit të mirë, njohja fillestare e aseteve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim i biznesit dhe që nuk ka ndikim as në kontabilitet as në fitim të tatueshëm, dhe diferencat në lidhje me investimet në entitete vartëse dhe me kontroll të përbashkët deri aty ku ato ka mundësi që nuk do të kthehen në të ardhmen e parashikuar. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, bazur në ligjet që janë në fuqi në datën e raportimit.

Aseti i tatimit të shtyrë është njohur kur është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Asetet e tatimit të shtyrë janë rishikuar në secilën datë të raportimit dhe janë reduktuar ashtu që nuk është e mundur më tej që përfitimi i ndërlidhur tatimor të realizohet.

n) Tatimi shtesë mbi fitimin neto

Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/56, "Mbi tatimin shtesë mbi fitimin neto të korporatës për ndërmarrjet që operojnë nga një pozicion dominant i tregut brenda Kosovës", nga PTK-ja kërkohet të paguajë një tatim shtesë mbi " fitimin vjetor neto pas tatimit". Ky tatim shtesë në normën 30% është detyrim duke filuar nga viti kalendarik i përfunduar më 31 dhjetor 2005. Shuma e detyrimit o tatimit shtesë për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2005, 2006, dhe 2007 është paraqitur tek "Shpenzimi i tatimit në fitim" në pasqyrën e të ardhurave. Kjo nuk është e aplikueshme për Grupin-PTK prej 1 janarit 2008

o) Zotimet dhe kontingjentet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhjes së parasë që trupëzon përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike brenda Grupit është e mundur. Shuma e humbjes kontingjente është njohur si provision nëse ka mundësi që ngjarjet në të ardhmen do ta konfirmojnë atë, një detyrim i pësuar në datën e bilancit të gjendjes dhe një vlersim i arsyeshëm i shumës së humbjes së rezultuar të mund të bëhet.

p) Ngjarjet pasuese

Ngjarjet pas përfundimit të vitit që ofrojnë informacion shtesë mbi pozicionin e Grupit na datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfudimit të vitit që nuk janë ngjarje rregulluese janë shpalosur në shënime kur kanë qenë materiale.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënime të Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

4. PËRCAKTIMI I VLERËS REALE

Disa nga politikat e kontabilitetit dhe shpalosje të Grupit kërkojnë përcaktimin e vlerës reale, si për asetet dhe detyrimet financiare ashtu edhe për ato jo financiare. Vlerat reale janë përcaktuar për qëllime të matjes dhe/ose shpalosjes duke u bazuar në metodat në vazhdim. Ku ka qënë e aplikueshme, informacion i mëtejshëm mbi supozimet e bëra gjatë përcaktimit të vlerave reale është shpallur në shënime specifike për atë aset ose detyrim.

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Vlera reale e të arkëtueshmeve tregtare dhe është vlersuar në vlerën aktuale të rrjedhave të ardhme të parasë, e zbritur sipas normave të interesit në treg në datën e raportimit.

Detyrimet financiare jo-derivative

Vlera reale, e cila është përcaktuar për qëllime të shpalosjes, është llogaritur duke u bazuar në vlerën aktuale të kapitali dhe rrjedhjes së parasë së interesit në të ardhmen, zbritur në normën e interesit në treg në datën e raportimit. Për qiratë financiare norma e interesit në treg është përcaktuar duke u reeruar në marrëveshje të ngjashme të qirasë.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

Grupi i ekspozohet rreziqeve në vazhdim për shkak të përdorimit të instrumenteve të tij financiare:

- Rreziku i kreditimit
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut.

Ky shënim paraqet informata mbi ekspozimin e Grupit ndaj secilit nga rreziqet më lartë, objektivat, politikat dhe proceset për matje dhe menaxhim të rrezikut nga Grupi, si dhe menaxhimin e kapitalit nga Grupi. Shpalosjet e mëtejshme sasiore janë përfshirë përmes këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Menaxhmenti ka përgjegjësi të përgjithshme për themelimin dhe mbikqyrjen e kornizës punuese manxheriale të rrezikut të Grupit. Politikat e menaxhimit të riskut të Grupit janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e përballura nga Grupi, për të vendosur limitet e duhura të rrezikut dhe kontrollet, dhe për të mbikqyrur rreziqet dhe përmbajtjen ndaj limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut janë rishikuar rregullisht për të reflektuar ndryshimet në treg dhe kushte legjislative si dhe aktivitetet e Grupit.

Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare të Grupit nëse konsumatori ose pala e kundërt ndaj një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e obligimeve kontraktuale, dhe del kryesisht nga të arkëtueshmet e Grupit nga konsumatori dhe investimet në depozita bankare.

Të arkëtueshmet tregtare

Grupi ka themeluar një provision për dëmtim që përfaqëson vlersimin e tij për dëmet e pësura në lidhje me të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera si dhe investimet. Përbërësi kryesor i këtij lejimi është humbja kolektive e themeluar nga grupet e konsumatorëve të ngjashëm sa i përket humbjeve që janë pësuar por ende nuk janë identifikuar. Provisioni i humbjes kolektive është përcaktuar duke u bazuar në të dhënat historike të statistikave të pagesave për asetet financiare të ngjashme.

Investimet në depozita bankare

Grupi ka llogari të konsiderueshme rrjedhës edhe investive në të gjitha institucionet bankre në Kosovë. Ekspozimi i cekur i depozitave të Grupit është nën maksimumin prej 20% të të gjitha depozitave në secilën bankë lokale.

Garancitë

Politika e grupit është që të ofrojë garanci financiare vetëm me vendim të drejtorëve të autorizuar apo personelit kyq të menaxhmentit. Referojuni shënimit 26 i cili shpalos më tej gjendjen e garancive më 31 dhjetor 2008.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku se Grupi nuk do të jetë në gjendje të përmbush obligimet e tij financiare, sipas afateve të tyre. Çasja e grupit për menaxhimin e likuiditetit është që të sigurojë, për aq sa të jetë e mundur, se do të ketë gjithmonë likuiditet për të përmbushur detyrimet, si në kushte normale ashtu edhe të shtrënguara, pa e ballafaquar me humbje apo rrezik të dëmtimit të reputacionit të Grupit.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku se ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si kursi i këmbimit, normat e interesit dhe çmimet e ekuitetit do të ndikojnë në të hyrat e Grupit ose vlerën e instrumenteve të saj financiare. Objektiva e menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj këtij rreziku përbrenda parametrave të pranuar, duke e optimalizuar kthimin.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

5. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

Rreziku i valutës

Si tërësi, grupi nuk është i ekspozuar ndaj rrezikut të valutës sepse:

- Të ardhurat janë në Euro
- Blerjet e aseteve kryesore dhe materialeve të përdorura në aktivitetet investuese të Grupit janë në Euro
- Asetet financiare janë në Euro.

Rreziku i normës së interesit

Llogaritë e depozitave bankare të PTK-së fitojnë interes në normat fikse komerciale në datat e kontratave gjegjëse dhe kanë maturitet në data fikse. Grupi nuk ka huazime që bartin interes në vitet 2008 dhe 2007.

Menaxhimi i kapitalit

Politika e menaxhmentit është për mbajtjen e një baze të fortë të kapitalit ashtu që të mbahet besimi i tregut dhe të mbështetet zhvillimi i ardhshëm biznesor.

Në vitin 2008 kthimi i kapitalit ishte 15% (2007: 14%). Për shkak të kufizimeve të jashtme të vendosura nga rrethanat (p.sh. pamundësia të vendosen depozita jashtë vendit, proceset e gjata të prokurimit, etj) menaxhmenti i Grupit nuk mund të implementojë një menaxhim efektiv dhe specifik për ekonomitë e lira.

Nuk ka pasur ndryshime në çasjen e Grupit ndaj menaxhimit të kapitalit përgjatë vitit.

Grupi nuk i nënshtrohet kërkesave kontraktuale apo ligjore të kapitalit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

6. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET

	<u>Toka dhe ndërtesat</u>	<u>Linjat e rrjetit</u>	<u>Makineria dhe paisjet</u>	<u>Puna në progres</u>	<u>Totali</u>
<i>Kostoja / Vlersimi</i>					
Bilanci më 1 jan. 2007	22,404	26,926	60,430	50,384	160,144
Shtesat	123	593	1,886	13,087	15,689
Transferimet	188	11,363	21,163	(32,714)	-
Bilanci më 31 dhjetor 2007	22,715	38,882	83,479	30,757	175,833
Bilanci më 1 jan. 2008	22,715	38,882	83,479	30,757	175,832
Shtesat	218	365	1,088	24,390	26,061
Transferimet	153	8,058	7,883	(23,441)	(7,346)
Bilanci më 31 dhjetor 2008	23,086	47,305	92,450	31,706	194,547
<i>Zhvlersimi i akumuluar</i>					
Bilanci më 1 jan. 2007	(2,156)	(6,049)	(36,683)	-	(44,888)
Ngarkesa për periudhë	(1,146)	(3,388)	(17,377)	-	(21,911)
Bilanci më 31 dh. 2007	(3,302)	(9,437)	(54,060)	-	(66,799)
Bilanci më 1 jan. 2008	(3,302)	(9,438)	(54,060)	-	(66,799)
Ngarkesa për periudhë	(1,166)	(3,971)	(8,162)	-	(13,300)
Bilanci më 31 dhjetor 2008	(4,468)	(13,409)	(62,222)	-	(80,099)
<i>Vlera bartëse</i>					
Më 1 janar 2007	20,248	20,877	23,747	50,384	115,256
Më 31 dhjetor 2007	19,413	29,445	29,419	30,757	109,034
Më 1 janar 2008	19,413	29,444	29,419	30,757	109,034
Më 31 dhjetor 2008	18,618	33,896	30,228	31,706	114,448

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

6. PRONA, IMPIANTET DHE PAISJET (vazhdim)

Humbjet nga dëmtimi në vlerë dhe rimarrja e mëvonshme

Grupi vazhdimisht i vlerëson përparimet teknologjike mbi asetet fikse, duke rishikuar edhe funksionalitetin e qëndrueshmërinë e tyre në infrastrukturën ekzistuese. Në qoftë se ka ndonjë paisje të dëmtuar apo të vjetëruar, atëherë kryhet testi i dëmtimit në vlerë dhe paisja ose humb vlerë ose del nga përdorimi.

Prona, impiantet dhe pasijet në ndërtim

Prona, impiantet dhe pasijet në ndërtim lidhen kryesisht me pagesat në avans për të ekzekutuar planin investiv të Grupit për të ndërtuar kapacitet të rrjeteve fikse dhe mobile.

Garancitë

Asnjë pronë, impiant apo paisje nuk është dhënë si kolateral për ndonjë huazim.

Pronësia

Çështjet të pronësisë ekzistojnë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillim të administrimit të OKB-së në Kosovë në vitin 1999. Kjo paraqet një detyrim kontingjent të PTK-së që për momentin nuk është e kuantifikueshme. Zgjidhja e titullit është një element i instucionalizimit të statusit final të Kosovës, ku PTK-ja nuk është palë.

Çështje tjera

Nuk ka asete të siguruara nën kushtet e qirasë financiare.

Më 31 dhjetor 2008 asetet e zhvlersuara në tërësi janë 49,195 mijë Euro në kosto.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

7. ASETET E PATRUPËZUARA

	<u>Programet kompjuterike</u>	<u>Liçensat</u>	<u>Totali</u>
<i>Kostoja</i>			
Bilanci më 1 janar 2007	5,066	9,759	14,825
Shtesat	7,510	-	7,510
Bilanci më 31 dhjetor 2007	12,576	9,759	22,335
Bilanci më 1 janar 2008	12,576	9,759	22,335
Shtesat	7,346	-	7,346
Bilanci më 31 dhjetor 2008	19,922	9,759	29,681
<i>Zhvlersimi i akumuluar</i>			
Bilanci më 1 janar 2007	(4,984)	(1,672)	(6,656)
Ngarkesa për periudhën	(2,526)	(646)	(3,172)
Bilanci më 31 dhjetor 2007	(7,510)	(2,318)	(9,828)
Bilanci më 1 janar 2008	(7,510)	(2,318)	(9,828)
Ngarkesa për periudhën	(3,573)	(619)	(4,192)
Bilancim më 31 dhjetor 2008	(11,083)	(2,937)	(14,020)
<i>Vlera bartëse</i>			
Më 1 janar 2007	82	8,087	8,169
Më 31 dhjetor 2007	5,066	7,441	12,507
Më 1 janar 2008	5,066	7,441	12,507
Më 31 janar 2008	8,839	6,822	15,661

Programet kompjuterike ndërlidhen me koston e sistemit të faturimit dhe platformën e shërbimit të internetit.

Në vitin 2004 dy liçensa janë dhënë për 15 vite për të operuar me telekomunikacion përbrenda Kosovës, që përbëhen nga një liçensë e telefonisë mobile prej 6.5 milion Euro dhe një të telefonisë fikse prej 2.9 milion Euro.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

8. ASETET DHE DETYRIMET E TATIMIT TË SHTYRË

Asetet dhe detyrimet e njohura të tatimit të shtyrë

Norma e tatimit e aplikueshme nga Grupi paraqet normën e detyrueshme të tatimit të korporatës që është 20%. Llogaritja e tatimit të shtyrë ka marrë parasysh gjithashtu edhe normën e tatimit shtesë si dhe (referojuni politikës përkatëse të kontabilitetit), që është vënë në zbatim në vitin 2005 por pritet të përfundojë për PATK Grupin në vitin 2008. Prandaj, norma efektive e tatimit në të cilnë janë njohur asetet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë më 31 dhjetor 2008 është 10% (2007: 20% dhe 2006: 20%).

Asetet e tatimit të shtyrë të njohura në bilanc të gjendjes ndërlidhen me diferencat e përkohshme ndërmjet bazës së llogaritjes dhe asaj tatimore të pronës, impianteve dhe pasijeve:

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Asetet e tatimit të shtytë më 1 janar	6,915	5,747
Ndryshimi i njohur në pasqyrën e të ardhurave (shënimi 21)	(3.927)	1,168
Asetet e tatimit të shtyrë më 31 dhjetor	2,988	6,915

Asetet që nuk janë njohur të tatimit të shtyrë

Asetet e tatimit të shtyrë nuk janë njohur në lidhje me dëmtimin në vlerë të të arkëtueshmeve tregtare sepse nuk ka gjasa në këtë fazë që asetet e tilla do të përdoren në periudhat e ardhshme.

9. INVENTARI

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Kabllo dhe materialet e mirëmbajtjes.	4,186	4,029
Kartelat Sim dhe kartelat me gërvishtje	589	473
Artikujt postar	57	24
Inventari tjetër	184	207
	5,016	4,733

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

10. LLOGARITË E TË ARKËTUESHMEVE TREGTARE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Linjat fikse – personat fizik	14,299	15,783
Linjat fikse - kompanitë	17,263	15,513
Linjat fikse – personat fizik në proceset gjyqësore	3,332	3,355
Rrjeti i telefonisë mobile	8,414	6,091
Roaming – Monaco Telecom International	3,390	4,552
Telefonatat hyrëse – Monaco Telecom International	3,426	5,443
Shërbimet postare	669	524
Shërbimet e internetit	158	448
Llogaritë tjera të arkëtueshme	2,427	557
	<u>53,378</u>	<u>52,266</u>
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta	<u>(35,551)</u>	<u>(30,364)</u>
	<u>17,827</u>	<u>21,902</u>

Lëvizja në dëmtimin në vlerë për borxhet e dyshimta është përmbledhur si më poshtë:

	Telefonia fikse	Telefonia mobile	Posta	Totali
Bilanci hyrës më 1 janar 2007	24,181	1,342	-	25,523
Rritja/(Ulja)	3,698	1,067	110	4,875
Çregjistrimi i borxheve të këqia	(34)	-	-	(34)
Bilanci mbyllës më 31 dhjetor 2007	27,845	2,409	110	30,364
Bilanci hyrës më 1 janar 2008	27,845	2,409	110	30,364
Rritja/(Ulja)	2,664	2,566	37	5,267
Çregjistrimi i borxheve të këqia	(80)	-	-	(80)
Bilanci mbyllës më 31 dhjetor 2008	30,429	4,975	147	35,551

11. SHPENZIMET E PARAPAGUARA DHE TË ARKËTUESHMET TJERA

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Shpenzimet e parapaguara	3,648	1,718
Llogarit tjera të arkëtueshme	153	68
	<u>3,801</u>	<u>1,786</u>

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

12. PARAJA E GATSHME DHE BILANCET BANKARE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Llogaritë rrjedhës në bankat lokale	7,624	30,587
Depozitat bankare me maturitet fillestar tre ose më pak muaj	70,940	148,262
Paraja e gatshme	566	818
Paraja në transit	1	203
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në pasqyrën e rrjedhës së parasë	79,131	179,870
Investimet afatshkurtëra financiare (depozitat bankare me maturitet 3 deri 12 muaj), përfshirë depozitat që kanë të bëjnë me letër-kreditë e përdorura	169,913	42,871
Investimet afatgjata financiare (depozitat bankare me maturitet mbi 12 muaj)	-	5,254
Paraja e gatshme dhe bilancet bankare	249,044	227,995

Depozitat bankare janë mbajtur në të gjitha bankat e Kosovës. Nuk ka llogari rrjedhësë apo të investimit të mbajtur në bankat e huaja. Norma efektive e interesit e fituar nga depozitat bankare në vitin 2008 varion ndërmjet 2.4% dhe 6.1% (2007: 2.8% deri 5.4%). Të hyrat e fituara të interesit gjatë vitit 2008 janë 10,651 thousand mijë Euro (2007: 8,370 mijë Euro).

Paraja në transit paraqet paranë e arkëtuar në pikat e shitjes dhe të depozituar në bankat përkatëse, që janë debituar në llogaritë bankare të Grupit pas datës së bilancit të gjendjes.

Bilancet e mësipërme në banka janë paraqitur si neto të dëmtimit në vlerë të llogarive bankare në Bankën Kreditore të Prishtinës. Bilancet e mbetura me këtë bankë janë dëmtuar në vlerë në tërësi më 31 dhjetor 2007, si në vazhdim (referojuni shënimit 28):

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Depozitat afatshkurtëra bankare	13,751	14,564
Totali i dëmtimit në vlerë	13,751	14,564

Depozitat e kufizuara për letrat e papërdorura të kreditit

Përfshirë në bilancin e investimeve afatshkurtëra financiare është shuma prej 16,195 mijë Euro (31 dhjetor 2007: 6,286 mijë Euro) që është vënë si mbulësë në para kundër letrave të papërdorura të kreditit në datën e bilancit të gjendjes, të hapur për qëllime të blerjes së pronës, impianteve dhe paisjeve.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

13. KAPITALI I EMETUAR

Kapitali i emetuar që është regjistruar përfshinë 260 milion aksione, me vlerë nominale prej një Euro secila. Është formuar përmes përdorimit të llogarisë së kapitalit amë që ka ekzistuar më parë në shumën 36,842 mijë euro, dhe fitimet e mbajtura prej 223,158 mijë Euro.

Gjatë vitit 2008 Grupi ka njohur në humbje të akumuluar shumën prej 12,089 mijë Euro pjesa më e madhe e të cilës në shumën 10,873 mijë Euro lidhet me gjobitjet e pësura nga autoriteti tatimor në lidhje me vitet e tatueshëm 2002 deri 2005, dhe shuma e mbetur prej 1,216 ka të bëjë me bonuset e paguara për vitin 2007.

14. LLOGARITË E PAGUESHME TREGTARE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Monaco Telecom International	835	1,801
Furnitorët tjerë	6,272	6,033
	7,107	7,834

15. AKRUALET DHE TË PAGUESHMET TJERA

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Provisionet për gjobitjet dhe dënimet e autoriteteve tatimore (shiko shënimi 21)	-	3,973
Të pagueshmet e pagave	40	50
Depozita sigurimi të marra nga konsumatorët	87	1,269
Të pagueshmet e kontributeve pensionale në fondin pensinal të Kosovës	341	347
Të pagueshmet e TVSH-së	21	21
Të pagueshmet e tatimit në të ardhura personale	298	341
Akruallet tjera	7,031	4,800
	7,818	10,801

16. Të ardhurat e shtyera

	31 December 2008	31 December 2007
Kartat me gërvishje të telefonisë mobile	2,436	3,629
Tarifat e mobilave të faturuara më parë	98	-
	2,534	3,629

Të ardhurat e shtyera për sa i përket kartave me gërvishje ndërlidhen me pjesën e papërdorur në fund të vitit të kartave të shitura konsumatorëve të telefonisë mobile gjatë vitit.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

17. TË ARDHURAT OPERATIVE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Të ardhurat e shërbimeve të telefonisë	131,848	149,411
Të ardhurat e linjës fikse	25,330	27,188
Të ardhurat nga kabinat e telefonave publik	1,501	2,912
Të ardhurat e postës	1,774	1,829
Të ardhurat e shërbimeve të internetit	145	325
Të tjera	883	798
	161,481	182,463

18. KOSTOT OPERATIVE

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Kostot e rrjetit të telefonisë mobile	12,588	11,240
Komisionet për shërbimet e telefonisë mobile të ofruara nga MTI	2,415	2,236
Shërbimet publike	2,092	1,691
Kostot e derivateve	1,094	1,008
Linjat satelitore dhe paisjet	349	349
Kostot tjera operative	5,455	3,595
	23,993	20,119

19. KOSTOT E STAFIT

	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2007
Pagat	31,164	29,138
Kostot e pensionit – skema shtetërore	2,907	2,745
	34,071	31,883

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

20. KOSTOT TJERA

	31 December 2008	31 December 2007
Dëmtimi në vlerë i borxheve të dyshimta (shënimi 10)	5,267	4,875
Sigurimi dhe mirëmbajtja	2,111	2,321
Tarifat e liçensës, detyrimet doganore dhe tatimet	2,018	3,059
Qeraja	1,736	1,614
Marketingu	1,569	1,893
Shpenzimet e zyrës dhe administrative	1,267	1,252
Shërbimet për konsulencë	481	116
Shpenzimet e trajnimit	228	185
Të tjera	1,898	1,781
	16,575	17,096

Shpenzimet tjera përfshijnë tarifat për shërbimet bankare, kostot e udhëtimit, kostot e veturave, etj.

21. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT

Shpenzimi total i tatimit në të ardhura që është njohur në pasqyrën e të ardhurave përbëhet nga:

	2008	2007
Shpenzimet aktuale të tatimit		
Viti aktual	16,779	22,062
	16,779	22,062
Tatimi shtesë prej 30% mbi fitimin e tatueshëm pas tatimit në të ardhurat e korporatës	-	26,474
Totali i shpenzimit aktual për tatimin në të ardhura	-	48,536
Shpenzimi/(të ardhurat) e tatimit të shtyrë		
Prejardhja dhe anulimi i diferencave të përkohshme	3,927	(1,168)
	3,927	(1,168)
Totali i shpenzimit të tatimit në pasqyrën e të ardhurave	20,706	47,368

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

21. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur marrëdhënia ndërmjet shpenzimit të tatimit mbi të ardhura në pasqyrën e konsoliduar të ardhurave dhe fitimit kontabël:

	<u>2008</u>			<u>2007</u>		
	Rregullimet e tatimit (EUR'000)	Tatimi efektiv* (%)	Tatimi (EUR'000)	Rregullimet e tatimit (EUR'000)	Tatimit efektiv* (%)	Tatimi (EUR'000)
Fitimi kontabël para tatimit	80,831			97,705		
Tatimi mbi të ardhura duke përdorur normën standarde të tatimit**		20%	16,166		44%	42,990
Shpenzimet e pazbritshme:						
- zhvlersimi dhe amortizimi	(4,692)	-1.2%	(938)			
- dëmtimi në vlerë i borxheve të këqia	5,267	1.3%	1,053	4,876	2.2%	2,146
- gjobat dhe dënime	1	0.0%	0	144	0.1%	63
- shpenzimet tjera (jo-vendorët/kreditorët)	1,760	0.4%	352	2,423	1.1%	1,066
- akrualet e panjohura për qëllime tatimit	1,546	0.4%	309	-	-	-
- të ardhurat e patatueshme	(813)	-0.2%	(163)	(850)	(0.4%)	(374)
- e tejdhënë në vitet e mëparshme	-		-	-		-
Efekti nga paraqita e : përfundimit të tatimit shtesë, tatimi i ri i korporatës mbi tatimi e shtyrë që është njohur		5%	3,927		1.5%	1,477
Totali i shpenzimit të tatimit mbi të ardhura në pasqyrën e të ardhurave		25.6%	20,706		48.5%	47,368

*Norma mesatare efektive e tatimit është shpenzimi/(e ardhura) në përpjesëtim me fitimin kontabël.

** Norma standarde e tatimit përfshin tatimin mbi të ardhurat e korporatës prej 20% (2008), dhe efektet cumulative të tatimit mbi të ardhurat e korporatës prej 20% dhe tatimit shtesë prej 30% të llogaritur duke u bazuar në fitimin e tatueshëm minus tatimi mbi të ardhurat e korporatës (2007).

Duke u bazuar në zhvillimet e tregut konkurrues në industrinë në të cilën Grupi operon, tatimi i aplikueshëm shtesë prej 30% mbi fitimin e tatueshëm pas tatimit në të ardhurat e korporatës ka përfunduar më 01 janar 2008 (shiko shënimin 27).

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

21. SHPENZIMI I TATIMIT MBI TË ARDHURAT (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur harmonizimi i të arkëtueshmeve/pagueshmeve të tatimit të korporatës në datën e bilancit të gjendjes:

	2008	2007
Tatimi mbi të ardhurat e korporatës më 1 janar	(38,203)	(30,877)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi të ardhurat (përfshirë shtesën prej 30%)	(16,779)	(48,536)
Pagesat e tatimit në të ardhurave të bërë gjatë vitit	58,091	41,210
Tatimi mbi të ardhurat e korporatës (i pagueshë) më 31 dhjetor	3,108	(38,203)

22. INSTRUMENTET FINANCIARE

Rreziku i kreditimit

Për shka k të volumit të madh dhe shumëllojshmërisë së klientëve të PTK-së, përqëndrimet e rrezikut të kreditimit në lidhje me llogaritë e të arkëtueshmeve tregtare janë të kufizuara. Provisionsi për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta është paraqitur në shumën që konsiderohet si e nevojshme për të mbulluar rreziqet potenciale në arkëtimin e bilanceve të llogarive të arkëtueshme.

Grupi në mënyrë rutinore dhe të rregullt monitoron ekspozimin fondeve që kanë të bëjnë me likuiditetin në secilën bankë ku janë vendosur depozitat. Informacioni për likuiditetin jepet nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave në Kosovë në baza mujore.

Humbjet e dëmtimit në vlerë

	2008	2008	2007	2007
	Shuma bruto	Dëmtimi	Shuma bruto	Dëmtimi
Që nuk kanë tejkaluar afatet	375	-	11,790	-
Janë tejkalaur afatet 0-30 ditë	4,134	-	4,002	-
Janë tejkaluar afatet 31-90 ditë	9,122	(573)	4,863	(722)
Janë tejkalaur afatet 91-180 ditë	3,021	(983)	2,736	(1,323)
Janë tejkalaur afatet 181-360 ditë	4,454	(2,541)	2,372	(1,829)
Më shumë se një vit	32,272	(31,454)	26,503	(26,490)
	53,378	(35,551)	52,266	(30,364)

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

22. INSTRUMENTET FINANCIARE (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit

PTK-ja monitoron likuiditetin e saj në baza të shpeshta në mënyrë që të menaxhojë obligimet e saj kur ato duhet të kryhen. Një pjesë e rëndësishme e detyrimeve tregtare dhe të tjera duhet të kryhen brenda 6 muajve pas datës së bilancit të gjendjes për vitin 2007 dhe 2008.

Rreziku i valutës

Ekspozimi ndaj rrezikut të valutës

PTK-ja nuk i ekspozohet ndonjë rreziku të rëndësishëm pasi që shumica e transaksioneve të saj janë në Euro.

Analizat e ndjeshmërisë

Analizat e ndjeshmërisë nga ndrushimi i normave të këmbimit të euros kundrejt valutave tjera nuk do të kishin ndikim në pasqyrat e konsoliduara financiare të grupit për shkak të fakteve të theksuara më lartë.

Rreziku i normës së interesit

Llogaritë e depozitave bankare të PTK-së fitojnë interes në normat fikse komerciale në datat gjegjëse dhe maturojnë me data fikse. Grupi nuk ka huazime që bartin interes në vitin 2008 dhe 2007.

Vlerat reale kundrejt vlerave bartëse

Vlera reale është identifikuar si shuma për të ciln një asset und të këmbehet, osë një detyrim të shlyhet, ndërmjet palëve të mirëinformuara dhe të gatshme ne transaksione të lira. Vlera bartëse e aseteve financiare dhe detyrimeve financiare të PTK-së përafrohet me vlerën e tyre reale në datën e bilancit të gjendjes për shkak të normës efektive së kthimit të asetit.

23. PALËT E NDËRLIDHURA

Në rrjedhën normale të biznesit, PTK kryen transaksione gjatë periudhave financiare raportuese me konsumatorët si UNMIK-u, entitet qeveritare dhe personat të cilët janë të ndërlidhur me këta. Grupi ka gjithashtu palë të ndërlidhura me drejtorët dhe zyrtarët ekzekutiv të tij. Transaksionet monetare me palët e ndërlidhura dhe drejtorët e zyrtarët ekzekutiv të tij kanë qënë vetëm në lidhje me pagesat e mëposhtme:

	2008	2007
Blerja e tokës përmes privatizimit	7	-
Donacionet	13	133
Kompenzimet e Drejtorëve dhe Shefave Ekzekutiv	109	111
	129	244

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

24. ZOTIMET

Zotimet për blerje të pronës, impianteve dhe paisjeve

Më 31 Dhjetor 2008, Grupi ka hyrë në kontrata për blerje të tokës, impianteve dhe paisjeve në vlerë 277,327.81 Euro (31 dhjetor 2007: 6 milion Euro).

Qeratë në pozitën e qiramarrësit

Qeratë operative të pashlyera të cilat janë si të pagueshme :

	<u>2008</u>	<u>2007</u> <u>ristated</u>
Më pak se një vit	1,585	1,072
Ndërmjet një dhe pesë viteve	1,115	1,178
Më shumë se pesë vite	220	303
	<u>2,921</u>	<u>2,552</u>

Pjesa më e madhe e qirave operative ndërlidhet me qiranë e ndërtesave administrative për operimet e PTK-së.

25. PLANET PENSIONALE ME PËRFITIM TË DEFINUAR

Plani pensional me përfitim të definuar i Grupit është themeluar dhe është efektiv prej 1 janarit 2003. më 31 dhjetor 2005 të dy Shtojcat A dhe B janë mbyllur. Shtjca A dhe B ofron përfitime si shtesë të pensionit bazë të ofruar nga Departamenti i Mirëqënies Sociale në Kosovë, dhe pensionit të kursimeve personale të ofruar nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

Lëvizjet në detyrimin për obligimet e përfitimit të definuar:

	<u>2008</u>	<u>2007</u>
Më 1 janar	1,469	1,567
Kostot e shërbimit	(38)	(98)
Kontributet e paguara nën plan	<u>(1,431)</u>	<u>-</u>
Më 31 dhjetor	<u>-</u>	<u>1,469</u>

26. KONTINGJENTET

Seancat gjyqsore

Më 31 dhjetor 2008. seancat gjyqsore të ngritura kundër Grupit janë 3,200 mijë Euro. Në datën e bilancit të gjendjes të këtyre pasqyrave financiare, nuk k aprovisione nga humbjet potenciale të regjistruara që kanë të bëjnë me seancat. Menaxhmenti i grupit, në mënyrë të rregullt analizon rrezikun potencial që del nga humbjet me seancat gjyqsore, së bashku me seancat dhe të arkëtueshmet e mundshme me synim kundër Grupit, që mund të dalin në tëardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet që gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Grupit beson se nuk to të kenë si rezultat detyrime materiale.

Pronësia mbi pronën, impiantet dhe paisjet

Shënimi 6, prona, impiantet dhe paisjet, i referohet çështjeve të pronësisë në lidhje me infrastrukturën e trashëguar në fillimin e Administratës së OKB-së në Kosovë. Kjo paraqet një detyrim kontingjent për PTK-në i cili nuk është e mundur të kuantifikohet në këtë kohë.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.

Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008

(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

26. KONTINGJENTET (vazhdim)

Garancitë në favor të palëve të treta

Më 31 dhjetor 2008, totali i garancioneve të lëshuara në favor të palëve të treta (kryesisht furnitorëve të PTK-së) janë 208 mijë Euro.

Zotimet kapitale

Nuk ka zotime madhore kapitale të kontraktuara në datën e bilancit të gjendjes të cilat tashmë nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

27. NGJARJET PASUESE

Pas datës së bilancit të gjendjes dhe përpara lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, janë këto ngjarje me ndikim të rëndësishëm në operimet biznesore të Grupit:

Pas datës së bilancit të gjendjes proceset gjyqësore të ngritura kundër Grupit janë rritur për shumën 1,404 mijë Euro. Pjesa më e madhe e kësaj shume i referohet proceseve gjyqësore të ndërmarrjes Prompt ndaj Grupit.

28. VLERSIMET DHE GJYKIMET E KONTABILITETIT

Menaxhmenti ka diskutuar me Komisionin e Auditimit, Financave dhe Sigurimit, dhe me Komisionin Këshillues të Bordit të Drejtorëve të PTK Sh.a. zhvillimin, përzgjedhjen dhe shpaltosjen e politikave dhe vlersimeve të rëndësishme të kontabilitetit si dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlersimeve.

Burimet kryesore për pasigurinë e vlersimeve

Mungesa enjë marrëveshje të ndërlidhjes me Telekom Serbia

PTK-ja i lidh telefonatat fikse me administratat e huaja përmes Beogradit me linjat fikse të menaxhuara nga Telekom Serbia. As në të kaluarën dhe as tani nuk ka kontratë ndërmjet PTK-së dhe Telekom Serbisë. Mungon një marrëveshje e ndërlidhjes që do të rregulonte marrëdhëniet në lidhje me trafikun e telekomunikimit.

Menaxhmenti i PTK-së e vleron si joreale pranimin e ndonjë shlyerje retrospective në lidhje me trafikun e telefonisë ndërmjet Telekom Serbia dhe PTK-së, dhe përkundrazi e vleron sit ë mundur që zhvillimet e pezulluara politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të zgjasin disa vite përpara së të mund të caktohet ndonjë marrëveshje e ndërlidhjes ndërmjet palëve.

Në mungesë të marrëveshjes formale të ndërlidhjes ë do të caktonte tarifat për telefonata hyrëse dhe dalëse drejt/nga rrjeti '381', nuk është praktike të matet vlera e një trafiku të tillë. Megjithatë është e matshme që thirrje hyrëse në hapësirat e Kosovës të rrjetin '381' (thirrjet që përfundojnë në Kosovë) janë shumë më të larta se trafiku dalës nga Kosova dhe jashtë ("thirrjet dalëse"). Kjo tregon se nëse caktohet marrëveshja, ka gjasa të rrisë të ardhurat neto në favor të PTK-së. pasi që shlyerjet retrospective konsiderohen joreale për momentin, këto pasqyra të konsoliduara financiare nuk reflektojnë ndonjë efekt financiar, nga trafiku i tillë ndërkombëtar si përket aseteve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Rimarrja e llogarive dhe depozitave bankare

Pas fundvitit 2005, Banka Kreditore e Prishtinës, me të cilën Grupi ka të depozita më 31 dhjetor 2005, ka hyrë në procesin e falimentimit pas heqjes së licensës së saj nga Autoriteti Bankar dhe I pagesave në Kosovë më 13 Mars 2006. Është bërë provision në këto pasqyra të konsoliduara financiare dhe ato të viteve të mëparshme për bilancet më 31 dhjetor 2008 dhe 2007 që janë 13,751 mijë Euro dhe 14,564 mijë Euro, pasi që ekzistojnë pasiguri mbi rimarrjen e balanceve në bankë. Në vitin 2007, 813 mijë Euro janë rimbursuar dhe gjegjësisht janë njohur si të ardhura.

Deri në atë masë së është ende e p[amundër të përcaktohet rezultati i procesit të likuidimit dhe shuma e depozitave të garantuara nga BPK, egzistojnë pasiguri mbi rikthimin e balanceve në këtë bankë. Prandaj, një humbje e dëmtimit në vlerë prej 100% e shumës së mbajtur në bankë është miratuar. Nëse ka mjaft asete të likuidimit për të mbuluar kërkesat e kreditorëve, të ardhurat do të njihen në periudhat e ardhshme deri tek shuma e rikthyer.

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Holding Sh.a.
Shënimet e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008
(në mijë Euro, përveq nëse është theksuar ndryshe)

28. VLERSIMET DHE GJYKIMET E KONTABILITETIT (vazhdim)

Toka e përdorur nga Grupi

Menaxhmenti është i mendimit se disa ngastra toke janë menduar të jenë në pronësi të PTK-së nga pikëpamja e përdorimit të vazhdueshëm që hyn tek definicionet e pronësisë në Kosovë. Aktualisht nuk mund të aplikohet një vlerë mbi këto asete. Në kohën e verifikimit të aseteve ky artikull është lënë jashtë, për shkak të pasigurive mbi titullin ligjor.

Ndërtesat e përdorura nga Grupi

Gjatë verifikimit të aseteve në periudhat e mëparshme pronësia e disa ndërtesave, të identifikuarat sin ë përdorim dhe kontroll të PTK-së, nuk ka mundur të vendoset për shkak të mungesës në çasje apo mungesës së dokumentacionit të pronësisë. Momentalisht nuk mund të aplikohet një vlerë mbi këto asete.

Gjykimet vendimtare të kontabilitetit në aplikimin e politika të kontabilitetit të Grupit

Rimarrja e të arkëtueshmeve tregtare

Është përgatitur një vlersim i shumave që mund të rimirren nga të arkëtueshmet mbi bazën e kategorisë së konsumatorit, duke u bazuar në përvojën mbi rimarrjen.